



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM DIBËR

DATA 03.02.2026

NJOFTIM
PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR 1 (NJË) VEND VAKANT
NË POZCIONIN E PUNËS PUNONJËSE SHËRBBIMI

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër bazuar në Ligjin Nr. 97 të vitit 2016 *“Për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbi bazën e strukturës organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, miratuar me urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.21, datë 22.01.2026, dërguar me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm nr.120/9 prot., datë 26.01.2026;

NJOFTON

Fillimin e Proedurës së konkurimit të hapur të kandidatëve për **1 (një) vend pune në pozicionin “Punonjëse shërbimi” (gjinia femër)**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Kushtet e përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe të mos jetë nën hetim;
- f) ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore në marrëdhënie pune dhe/ose shërbim civil, që nuk është shuar sipas ligjit;
- g) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- h) të jetë e gjinisë femër.

2. Kushtet e posaçme:

- a) Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë;
- b) Të ketë aftësi komunikimi etik dhe profesional me publikun dhe shtetasit;

- c) Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup;
- d) Të ruajë sekretin hetimor;
- e) Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale si dhe sjellje etike.

3. Kriteria të preferuara:

- a) Të ketë eksperiencë të mëparshme pune në detyra që kanë pasur të bëjnë me komunikimin me qytetarët dhe me publikun, me rendin dhe sigurinë në institucione ose në institucione të tjera të sigurisë, mbrojtjes ose rendit publik.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, deri në datën **18.02.2026** ora **16.00**, këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim;
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë;
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto;
- d) Diplomë e shkollës së mesme;
- e) Dëshmi penaliteti;
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
- g) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim mbi masat disiplinore në fuqi;
- i) Vërtetim vendbanimi;
- j) Vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore;
- k) Referenca të mundshme nga punëdhënësi të mëparshëm;
- l) Formular vetdeklarimi për gjendjen gjyqësore penale.

Konkurimi zhvillohet në dy faza:

Faza parë: Verifikimi paraprak i dokumentacionit

Verifikimi paraprak i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim do të bëhet nga Komisioni i Pranimi pranë kësaj Prokurorie. Kandidatët që nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë: Intervista.

Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.

Kundër vendimeve të Komisionit të Pranimi në cdo fazë të konkurimit të kësaj procedure aplikuesit mund të paraqesin ankim me shkrim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Afati i ankimit është 5 ditë nga e nesërmja e njoftimit.

Pikëzimi i renditjes së aplikantëve të kualifikuar është si vijon:

Dokumentacioni 60 pikë.

Intervista 40 pikë.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR